

VENDIM
Nr. 604, datë 31.8.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 872, DATË 30.10.2015, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2016, TË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 872, datë 30.10.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 1, shuma “... 40 258 000 (dyzet milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... 43 756 000 (dyzet e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë ...”.
 - b) Pasqyra nr. 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me pasqyrën me të njëjtin numër që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Pasqyra nr. 1
PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR VITIN 2016

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve	në lekë
1	Shpenzime për paga	25 577 000
2	Sigurime shoqërore	3 914 000
3	Shërbime e furnitura	13 000 000
4	Investime	1 265 000
	TOTALI	43 756 000